



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 maj 2020
Nr. Ref.:RK 1569/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI59/19

Parashtrues

Snežana Nešević

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të
Kosovës, Ac. nr. 203/14, të 17 dhjetorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesja e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Snežana Nešević me vendbanim në Bijelo Polje, Republika e Malit të Zi, e përfaqësuar nga Idriz Daci, avokat nga Komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Ac. nr. 203/14] të 17 dhjetorit 2018 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) në lidhje me Aktgjykimin [C.nr.653/09] e 11 nëntorit 2013 të Gjykatës Themelore në Pejë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit, përmes të cilit pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të saj të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ); nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenin 17 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

5. Më 11 prill 2019, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 16 prill 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.
7. Më 19 prill 2019, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës, përkatësisht avokati Idriz Daci, dorëzoi një autorizim me të cilin vërteton se parashtruesja e kërkesës e autorizon të njëjtin për ta përfaqësuar para Gjykatës lidhur me kërkesën e saj.
8. Më 16 maj 2019, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës u njoftua për regjistrim të kërkesës dhe Gjykata kërkoi nga ai plotësimin e formularit të kërkesës. Të njëjtën datë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës së Apelit.
9. Më 24 maj 2019, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës e dorëzoi formularin e kërkesës së plotësuar dhe disa dokumente shtesë.

10. Më 26 qershor 2019, parashtruesja e kërkesës dorëzoi një formular shtesë të kërkesës në Gjykatë. Ajo nuk kishte përcaktuar në formular nëse përfaqësohet nga avokati Idriz Daci.
11. Më 1 gusht 2019, Gjykata dërgoi një shkresë tek parashtruesja e kërkesës dhe kërkoi nga ajo sqarim nëse përfaqësohet nga avokati Idriz Daci para Gjykatës.
12. Më 22 gusht 2019, parashtruesja e kërkesës njoftoi Gjykatën se avokati Idriz Daci e përfaqëson atë.
13. Më 22 prill 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

14. Nga shkresat e lëndës, përkatësisht historiatin e lëshuar nga Komuna e Pejës sipas kërkesës së Gjykatës Themelore, rezulton që në vitin 1932, patundshmëritë, përkatësisht (i) ngastra kadastrale me numër 4774, me kulturë arë, klasa e katërt me sipërfaqe prej 2.42.32 ha; dhe (ii) ngastra kadastrale 4778, me kulturë kullosë, klasa e tetë me sipërfaqe 0.28.93 ha, ishin të regjistruara në emër të Z.V.V.
15. Në vitin 1937, ngastra kadastrale me numër 4774, ndahet në (i) ngastrën kadastrale 4774/1 me sipërfaqe 1.33.80 ha dhe e cila, bazuar në historiatin e lëshuar nga Komuna e Pejës, tjetërsohet në "*pronësi të ujërave*"; dhe (ii) ngastrën kadastrale 4774/2 në sipërfaqe 0.82.70 ha.
16. Në vitin vitin 1956, ngastra kadastrale numër 4774/2 me sipërfaqe prej 0.82.83 ha dhe ngastra 4778 me sipërfaqe prej 0.29.15 ha, përmes procesit të quajtur reambullim, e sipas pretendimit të parashtrueses së kërkesës në mënyrë të kundërligjshme, u regjistrua në emër të Z.S.-së, përkatësisht e veja e Z.R.-së., dhe i cili ishte vëllau i Z.V.V.-së.
17. Më 25 tetor 1971, përmes Aktvendimit [O.br.151/71] mbi Trashëgiminë, patundshmëritë përkatëse u regjistruan në emër të Z.S.-së, por edhe Z.S., Z.R., XH.A. dhe B.S. me nga një të pestën (1/5-tën) e patundshmërisë përkatëse.
18. Sipas deklaratës së parashtrueses së kërkesës, Z.V.V., ishte gjyshi i saj, dhe ajo nuk kishte ditur për patundshmërinë e tij deri sa ishte njoftuar nga personi GJ.A.
19. Më 2 shtator 2009, parashtruesja e kërkesës dhe shtatë (7) paditës të tjerë, parashtruan padi për vërtetimin e pronësisë mbi bazën e trashëgimisë si pasardhës të Z.V.V.-së, pranë Gjykatës Themelore. Parashtruesit e padisë kishin kërkuar nga gjykata përkatëse që (i) të vërtetohet se janë pronarë të ngastrës kadastrale me nr.4774 dhe nr.4778 në sipërfaqe prej 1.11.98 ha, nga fleta poseduese nr.1561 në Zonën Katastrale në Pejë; dhe (ii) t'i obligojë të paditurit GJ.A, Z.R, Z.M, Z.B, B.P, dhe B.N, t'ua njohin këtë të drejtë dhe t'i lejojnë paditësit, përkatësisht parashtruesen e kërkesës dhe shtatë (7) paditësit e tjerë të regjistrohen në librat kadastral si pronarë të patundshmërisë.

20. Sipas shkresave të lëndës, parashtruesja e kërkesës dhe shtatë (7) paditësit e tjerë, kishin dorëzuar dhe disa parashtrësia pranë Gjykatës Themelore. Në njërin nga parashtrësit, parashtruesja e kërkesës kishte kërkuar që nga ana e ekspertit të sqarohet se si është kaluar pronësia nga Z.V.V. në pronësi të Z.S.-së. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu kishte theksuar se është i pabazuar pohimi i të paditurve se bartja e pronës nga i ndjeri Z.V.V. në Z.S., është bërë në bazë të marrëveshjes e cila ka ekzistuar në atë kohë në mes të trashëgimtarëve.
21. Më 11 nëntor 2013, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.653/09] refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës dhe shtatë (7) paditësve të tjerë. Gjykata Themelore, bazuar në Aktgjykimin përkatës, gjendjen faktike e vërtetoi përmes (i) Aktvendimit [O.br.151/71] mbi Trashëgiminë të 25 tetorit 1971; (ii) Certifikatës [nr.01-3/1652] të 2 tetorit 2008; dhe (iii) historiatit [nr.01-31] të 15 marsit 2013 të lëshuar nga Komuna e Pejës.
22. Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit të lartcekur, arsyetoi se (i) paraardhësit e parashtrueses së kërkesës dhe paditësve të tjerë, kanë pasur mundësi që në afat ligjor të kundërshtojnë Aktvendimin [T.nr.151/71] mbi Trashëgiminë të 25 tetorit 1971; dhe (ii) në mungesë të këtij veprimi, padia e paditësve përkatës ishte parashkruar bazuar në nenin 125 të Ligjit mbi Trashëgiminë Gazeta Zyrtare e KSAK-së e 30 dhjetorit 1974 (në tekstin e mëtejme: Ligji për Trashëgiminë i KSAK-së) dhe nenin 138 (Parashkrimi i së drejtës për të kërkuar pasurinë trashëgimore) të Ligjit Nr.2004/26 mbi Trashëgiminë të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji për Trashëgiminë).
23. Më 17 dhjetor 2013, parashtruesja e kërkesës dhe paditësit e tjerë, parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore. Përgjigje në ankesë kishin parashtruar edhe të paditurit. Të parët, përkatësisht parashtruesja e kërkesës dhe paditësit e tjerë, pretenduan (i) shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, me arsyetimin se disa nga procesverbalet nuk u janë dorëzuar në gjuhën serbo-kroate dhe nuk iu është dhënë mundësia e deklaramit rreth provave në shqyrtim gjyqësor; (ii) konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, nuk ka vërtetuar që Z.R., ka qenë pronar i patundshmërisë sepse sipas aktit të vdekjes të tij është e qartë që ai nuk ka lënë asnjë pasuri të patundshme; dhe (iii) aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, për arsye se bazuar në nenin 37 (Mbrojtja e së drejtës së pronësisë) të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore të 30 janarit 1980 (në tekstin e mëtejme Ligji mbi Marrëdhëniet Juridiko-Pronësore), e drejta e paraqitjes së padisë nga paragrafi 1 i të njëjti nen, nuk parashkruhet.
24. Më 17 dhjetor 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr. 203/14] refuzon si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe paditësve të tjerë, duke vërtetuar Aktgjykimin [C.nr.653/09] e 11 nëntorit 2013 të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit theksoi se (i) e drejta e paditësve ishte parashkruar sepse nuk ishte paraqitur padi në afatin ligjor të përcaktuar përmes nenit 125 të Ligjit mbi Trashëgiminë të KSAK-së dhe nenit 138 të Ligjit mbi Trashëgiminë; dhe (ii) duke marrë parasysh se e drejta e padisë ishte parashkruar, pretendimet e tjera nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe të rastit.

25. Sipas deklaratimit të parashtrueses së kërkesës, ajo i ishte drejtuar Prokurorit të Shtetit më kërkesën për iniciimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, kërkesë kjo e cila përmes shkresës [KMLC.nr.67/2019] së Zyrës së Prokurorit të Shtetit, nuk ishte miratuar. Parashtruesja e kërkesës nuk ka paraqitur revizion në Gjykatën Supreme.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

26. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktgjykimi [Ac.nr.5706/17] i 15 marsit 2018 i Gjykatës së Apelit është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të saj të përcaktuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së si dhe nenin 46 [Mbrojtja e pronës] të Kushtetutës dhe nenin 17 të DUDNJ-së.
27. Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesja e kërkesës thekson se gjykatat e rregullta nuk kanë (i) vërtetuar drejtë ligjshmërinë e Aktvendimit [T. nr. 151/71] mbi Trashëgiminë të 25 tetorit 1971, sepse, sipas pretendimit, trashëgimtarë i pronave të kontestuar është Z.V.V. dhe jo Z.R., mbi emrin e bashkëshortes së cilit, ishin regjistruar pronat kontestuese në vitin 1956 dhe më pas ishin vërtetuar përmes Aktvendimit mbi Trashëgiminë të vitit 1971; (ii) aplikuar drejt Ligjin për Marrëdhëniet Juridiko-Pronësore, kur kanë konstatuar parashkrimin e të drejtës së paditësve sepse të drejtat e përcaktuara përmes paragrafit 1 të nenit 37 të tij nuk parashkruhen; dhe (iii) aplikuar drejtë Ligjit mbi Trashëgiminë të KSAK-së dhe Ligjit mbi Trashëgiminë, përkitazi me nenet 125 dhe 138 të tyre, respektivisht.
28. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendon se (i) Gjykata e Apelit gjatë shqyrtimit të ankesës nuk ka marrë për bazë provat e bashkangjitura nga ajo, përkatësisht provat që vërtetojnë se ajo dhe paditësit e tjerë *“janë pronarë të ngastrës kadastrale nr.4774 dhe nr.4778 të evidentuara sipas fletës poseduese nr.1561 ZK Pejë”*; dhe (ii) çështja e tyre në Gjykatën e Apelit nuk ishte zgjidhur brenda një afati të arsyeshëm kohor, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
29. Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, parashtruesja e kërkesës pretendon se në kundërshtim me këtë nen dhe nenin 17 të DUDNJ-së, ajo *“është privuar në mënyrë arbitrare nga pasuria si trashëgimtare e të ndjerit Z.V.”*.
30. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që kërkesa e saj të shpallet e pranueshme dhe të shpallet i pavlefshëm Aktgjykimi [Ac.nr.203/14] i 17 dhjetorit 2018 i Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktgjykimin [C.nr. 653/09] e 11 nëntorit 2013 të Gjykatës Themelore, dhe lënda të kthehet në ri-vendosje.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...]

Neni 46

[Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.
[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohej nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.
[...]

Protokolli nr. 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 1

(Mbrojtja e pronës)

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.
[...]

Ligji për Trashëgiminë i KSAK i vitit 1974

Parashkrimi i së drejtës për të kërkuar pasurinë trashëgimore

Neni 125

E drejta për të kërkuar pasurinë trashëgimore si trashëgimtar i trashëgimlënësit parashkruhet ndaj poseduesit me mirëbesim brenda dy vjetësh nga dita që trashëgimtari ka marrë dijeni për të drejtën e vet dhe për posedimin e sendeve nga pasuria trashëgimore, e më së largu brenda 10 vjetësh duke llogaritur për trashëgimtarin ligjor nga vdekja e trashëgimlënësit, për trashëgimtarin me testament nga shpallja e testamentit.

Ndaj poseduesit me keqbesim kjo e drejtë parashkruhet brenda 20 vjetësh.

Ligji Nr. 2004/26 për Trashëgiminë i Kosovës

Neni 138

[Parashkrimi i së drejtës për të kërkuar pasurinë trashëgimore]

138.1.E drejta për të kërkuar pasurinë trashëgimore si trashëgimtar i trashëgimlënësit parashkruhet ndaj poseduesit me mirëbesim brenda një viti nga dita që trashëgimtari ka marrë dijeni për të drejtën e vet dhe për poseduesin e sendeve nga pasuria trashëgimore dhe në çdo rast jo më vonë se 10 vjetë duke llogaritur për trashëgimtarin ligjor nga dita e vdekjes e trashëgimlënësit, kurse për trashëgimtarin me testament nga shpallja e testamentit.

138.2.Ndaj poseduesit me keqbesim kjo e drejtë parashkruhet brenda 20 vjetësh nga koha parashikuar në paragrafin 1.

Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore i 30 janarit 1980

Neni 37

3. [Mbrojtja e së drejtës së pronësisë]

Pronari mund të kërkojë me padi nga mbajtësi kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale.

Pronari duhet të provojë se mbi sendin kthimin e të cilit e kërkon ka të drejtën e pronësisë dhe se sendi gjendet nën zotërimin faktik të të paditurit e drejta e paraqitjen së padisë nga paragrafi 1 i këtij neni nuk parashkruhet.

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

33. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve, 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashohin:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

34. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar dhe e cila e konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Ac.nr. 203/14] e 17 dhjetorit 2018 të Gjykatës së Apelit, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të

përcaktuara me ligj. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ajo pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

35. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

36. Gjykata në këtë aspekt fillimisht rikujton që gjyshi i parashtrueses së kërkesës, përkatësisht Z.V.V., kishte qenë i evidentuar në vitin 1932 si pronar i ngastrave kadastrale 4774 dhe 4778 në Zonën Katastrale të Pejës. Që nga viti 1956, ngastrat kadastrale 4774/2 dhe 4778, përmes procesit të reambullimit, u evidentuan si të regjistruara në emër të Z.S.-së. Kjo pasuri, përmes Aktvendimit [O.br.151/17] mbi Trashëgiminë të 25 tetorit 1971 kaloi në emër të Z.S.-së dhe Z.S., Z.R., XH.A. dhe B.S. me nga një të pestën (1/5-tën) e pronësisë. Në vitin 2009, parashtruesja e kërkesës, pretendon të ketë kuptuar për patundshmërinë në fjalë dhe trashëgimtare e të cilës pretendon të jetë bashkë me shtatë (7) paditës të tjerë. Megjithatë, padia e tyre për vërtetimin e pronësisë përkitazi me patundshmërinë përkatëse, u refuzua nga Gjykata Themelore, dhe u vërtetua nga Gjykata e Apelit. Në esencë, gjykatat e rregullta arsyetojnë se që nga viti 1971, përkatësisht viti në të cilin është nxjerrë Aktvendimi i trashëgimisë e deri në momentin e padisë në vitin 2009, të drejtat e paditësve ishin parashkruar. Këtë konstatim, dhe siç është cekur më lart, gjykata e rregullta e bazojnë në nenin 125 të Ligjit mbi Trashëgiminë të KSAK-së dhe nenin 138 të Ligjit mbi Trashëgiminë. Parashtruesja e kërkesës konteston interpretimin e ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta në Gjykatë, duke pretenduar shkelje të nenit 31 dhe 46 të Kushtetutës.
37. Në këtë kontekst dhe në vijim, Gjykata do t'i trajtojë pretendimet e parashtrueses së kërkesës përkitazi me (i) shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, përkatësisht të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e që në rrethanat e rastit konkret në esencë ndërlidhen me interpretimin e gabuar të ligjit; dhe (ii) shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës, përkatësisht shkeljen e të drejtës në pronë, duke aplikuar praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), mbi bazën e të cilës Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

(i) *Përkitazi me pretendimet për shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm*

38. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së përcakton se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi. (Shih, në këtë kontekst rastin e GJEDNJ-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi të 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, Gjykata gjithashtu do t'i përmbahet këtij parimi. (Shih, rastet e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe rastin KI143/16, parashtrues, *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).
39. Më specifikisht dhe përkitazi me pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata thekson se parashtruesja e kërkesës e ndërtoi rastin e saj mbi baza ligjshmërie, përkatësisht mbi vërtetimin e fakteve dhe interpretimin e gabuar të ligjeve, duke pretenduar specifikisht se përkundër konstatimit të gjykatave që e drejta e parashtrueses së kërkesës dhe paditësve përkatës përkitazi me pronën kontestuese është parashkruar bazuar në nenin 125 të Ligjit mbi Trashëgiminë të KSAK-së dhe nenin 138 të Ligjit mbi Trashëgiminë, bazuar në paragrafin e parë të nenit 37 të Ligjit për Marrëdhëniet Juridiko-Pronësore, e drejta e paditësve nuk është parashkruar. Gjykata rikujton se këto pretendime kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës, dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata. (Shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI56/17, parashtruese, *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35).
40. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (*ligjshmëria*), përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (*kushtetutshmëria*). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 29; KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 dhjetorit 2017, paragrafi 37; KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 qershorit 2018, paragrafi 57; dhe KI154/17 dhe KI05/18, parashtrues *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar Barbas*", Aktvendim për papranueshmëri i 22 korrikut 2019, paragrafi 61).
41. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale. (Shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës

KI06/17, cituar më lart, paragrafi 38; KI122/16, cituar më lart, paragrafi 58; dhe KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 62).

42. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat mund të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. GJEDNJ ka theksuar se përderisa autoritet vendore, përkatësisht, në kontekst të rastit gjykatat e rregullta, kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të legjislacionit, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me Kushtetutën dhe KEDNJ-në. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39).
43. Rrjedhimisht, edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në kuptimin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur një gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesen e kërkesës. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 11 janarit 2007, paragrafi 83; dhe gjithashtu, rastet e Gjykatës KI06/17, cituar më lart, paragrafi 40; KI122/16, cituar më lart, paragrafi 59; dhe KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 64).
44. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që parashtruesja e kërkesës nuk pretendon dhe as argumenton “*aplikim të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar*” dhe i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesen e kërkesës, duke u bazuar në praktikën e GJEDNJ-së por edhe atë të Gjykatës. Megjithatë, ajo pretendon se ligji i aplikueshëm në rastin e saj nuk është aplikuar drejtë nga gjykatat e rregullta, përkitazi me nenin 125 të Ligjit mbi Trashëgiminë të KSAK-së; nenin 138 të Ligjit mbi Trashëgiminë; dhe nenin 37 të Ligjit për Marrëdhëniet Juridiko-Pronësore.
45. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht thekson se neni 125 i Ligjit mbi Trashëgiminë të KSAK-së, përcakton parashkrimin e të drejtës për të kërkuar pasurinë trashëgimore. Sipas këtij neni, e drejta për të kërkuar një pasuri trashëgimore si trashëgimtar i trashëgimlënësit parashkruhet ndaj poseduesit me mirëbesim brenda dy (2) vitesh nga dita që trashëgimtari ka marrë dijeni për të drejtën e vet, dhe për posedimin e sendeve nga pasuria trashëgimore. Ky nen, po ashtu përcakton që kjo e drejtë parashkruhet më së largu brenda njëzetë (20) vjetësh, duke u llogaritur për trashëgimtarin ligjor nga vdekja e trashëgimlënësit, ndërsa për trashëgimtarin me testament nga shpallja e testamentit. Në anën tjetër neni 138 i Ligjit mbi Trashëgiminë përcakton të njëjtat kushte, megjithatë dallon vetëm përkitazi me kohën e parashkrimit ndaj poseduesit me mirëbesim prej një (1) viti lidhur me ditën kur trashëgimtari ka marrë dijeni për të drejtën e tij. Në anën tjetër, dhe jo specifikisht lidhur me trashëgiminë, Ligji mbi Marrëdhëniet Juridiko-Pronësore, në nenin 37 të tij, përcakton se nuk ka parashkrim në rastet kur pronari kërkon me padi kthimin e sendit të caktuar, me kushtin që pronari (i) provon se mbi sendin, kthimin e të cilit e kërkon, ka të drejtën e pronësisë; dhe (ii) që sendi përkatës gjendet në zotërimin faktik të të paditurit.
46. Gjykata rikujton se Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr. 653/09] të 11 nëntorit 2013, duke u bazuar në këto dispozita kishte konstatuar se (i) pronësia

e paditësve në pronat kontestuese nuk ishte e dëshmuar duke marrë parasysh gjendjen faktike dhe historikun e pronës kontestuese; dhe (ii) bazuar në dispozitat e Ligjit mbi Trashëgiminë të KSAK-së dhe atij mbi Trashëgiminë, nenet 125 dhe 138, respektivisht, e drejta e paditësve për vërtetimin e kësaj pronësie ishte parashkruar. Në këtë kontekst, Aktgjykimi i lartcekur, përmban si në vijim:

“Patundshmëria mbi të cilën kanë pretendime palët paditëse në vitin 1932, evidentohet në emër të Z.V.V. Në vitin 1956 kjo patundshmëri me reambullim në librat kadastral regjistrohet në emër të Z.S. e lindur Dragojeviq e veja e Radivojes. Ndërsa në vitin 1971 në bazë të aktvendimit O.br. 151/71 pasuria kalon në Z.S. e veja e Radivojes, Z.S, Z.R, Xh.A dhe B. S me nga 1/5. Këtë gjendje gjykata e vërtetoi duke u mbështetur në Aktvendimin mbi trashëgiminë T. nr. 151/71 e dt. 25.10.1971, certifikatën me nr. 01-3/1652 e dt. 02.10.2008 dhe nga Historiati me nr. 01-31 të dt. 15.03.2013.

Po ashtu gjykata vlerësoi se paraardhësit e paditësve kane pasur mundësi që në afat ligjor ta kundërshtojnë vendimin mbi trashëgiminë T. nr. 151/71 i dt. 25.10.1971.

Mbi këtë bazë të vërtetuar faktike e duke marrë për bazë, Aktvendimin mbi Trashëgiminë T. nr. 151/71 të dt. 25.10.1971, dhe gjithë rezultatin e procedurës së zhvilluar e duke i zbatuar dispozitat e nenit 125 të Ligjit Mbi Trashëgiminë -Gazeta Zyrtare e KSAK e dt. 30.12.1974 dhe dispozitat e nenit 138 Ligjit të tanishëm mbi Trashëgiminë të Kosovës, Nr.2004/26, gjykata vendosi ta refuzoi kërkesë padinë e paditësve meqë kërkesa e tyre është parashkruar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.”

47. Për më tepër, Gjykata gjithashtu rikujton Aktgjykimin [Ac.nr. Ac.nr203/14] e 17 dhjetorit 2018 të Gjykatës së Apelit dhe, e cila në kontekst të interpretimit të ligjit të aplikueshëm, theksoi, si në vijim:

“Nuk janë pranuar pretendimet ankimore të autorizuarit të paditëseve për zbatim të gabuar të së drejtës materiale të paraqitura me ankesë, ngase sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, gjykata e shkallës së parë në përputhje me gjendjen faktike ka aplikuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale, duke iu referuar dispozitave të nenit 125 të Ligjit Mbi Trashëgiminë-Gazeta Zyrtare e KSAK e datës 30.12.1974 dhe dispozitat e nenit 138 të Ligjit Mbi Trashëgiminë të Kosovës nr.2004/26. Në rastin konkret Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejte ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar në kuptim të dispozitave të lart cituara, për faktin se nga shkresat e lëndës vërtetohet se paditësit nuk kanë paraqitur kërkesën e tyre brenda afatit ligjor të përcaktuar decidivisht nga neni 125 ku është paraparë se e drejta për të kërkuar pasurinë trashëgimore të dekujuarit duhet të parashtrohet në afat prej 2 viteve nga dita kur trashëgimtari ka kuptuar për të drejtën e tij.”

48. Më tej, dhe lidhur me pretendimet tjera të parashtrueses së kërkesës, Gjykata e Apelit konstatoi, si në vijim:

“Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të autorizuarit të paditëseve, mirëpo meqenëse të njëjtat nuk patën ndonjë ndikim për të vendosur ndryshe, Gjykata e Apelit është rezervuar në dhënien e arsyeve që dalin jashtë vlerësimit për çështjen e mbajtjes.”

49. Gjykata në këtë kontekst thekson se përkitazi me çështjen e parashtrimit të padisë nga ana e parashtrueses së kërkesë, Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit, kishin konstatuar se është e parashkruar, sepse padia nuk ishte paraqitur në afatin kohor përkatës kundër Aktvendimit [T.nr.151/71] mbi Trashëgiminë të 25 tetorit 1971, bazuar në nenin 125 të Ligjit mbi Trashëgiminë të KSAK-së dhe nenin 138 të Ligjit mbi Trashëgiminë. Si pasojë e një padie të paaftshme, gjykata nuk kishte marrë parasysh dëshmitë tjera të paditësve, përkatësisht parashtrueses së kërkesës e që ndërlidheshin me meritat e çështjes. Ky arsyetim i Gjykatës së Apelit, sqaron pretendimet e parashtrueses së kërkesës përkitazi me mos marrjen parasysh të dëshmive të cilat ajo pretendon se i ka paraqitur para gjykatave të rregullta.
50. Përderisa parashtruesja e kërkesës pranë kësaj Gjykate thekson se në rastin konkret ajo dhe paditësit e tjerë janë trajtuar si trashëgimtarë të Z.R.-së, e jo si trashëgimtarë të Z.V.V.-së, dhe konteston mënyrën se si është përfituar prona nga ana e bashkëshortes së Z.R.-së, Gjykata lidhur me këtë çështje vëren se, në rrethanat e rastit, kemi të bëjmë me familjarë, përkatësisht me të vëllain e Z.V.V.-së, prona e të cilit nga viti 1956 me reambullim në librat kadastral regjistrohet ne emër të Z.S.-së, e veja e Z.R.-së. Për më tepër, në vitin 1971 dhe siç është theksuar më lart, në bazë të Aktvendimit [O.br. 151/71] mbi Trashëgiminë, pasuria ka kaluar në emër të Z.S.-së, e veja e Z.R.-së, dhe katër (4) personave të tjerë, përkatësisht Z.S., Z.R., Xh.A. dhe B.S. me nga një të pestën (1/5-tën). Çështjen e pronësisë, gjykatat e rregullta e kishin vërtetuar duke u mbështetur ne Aktvendimin [T. nr. 151/71] mbi Trashëgiminë të 25 tetorit 1971; Certifikatën [nr. 01-3/1652] e 02 tetorit 2008; dhe Historiatin me nr. 01-31 të 15 marsit 2013 të Komunës së Pejës.
51. Rrjedhimisht, meqenëse me Aktvendimin [T. nr. 151/71] mbi Trashëgiminë të 25 tetorit 1971, të paditurit ishin bërë pronar të parcelave kadastrale përkatëse, dhe ndaj këtij Aktvendimi nuk ishte parashtruar padi nga paraardhësit e parashtrueses së kërkesës as njëzet (20) vjet pas nxjerrjes së tij, gjykatat e rregullta kishin konstatuar se ndaj kësaj padie ka kaluar afati i parashkrimit, siç është përcaktuar me ligjet përkatëse për trashëgiminë. Duke marrë parasysh që çështja ka të bëjë me parashkrim, Gjykata e Apelit u rezervua në dhënien e arsyeve që dalin jashtë vlerësimit të afatshmërisë së padisë. Për më tepër, Ligji mbi Marrëdhëniet Juridiko-Pronësore nuk ndërlidhet me trashëgiminë, ndërsa aplikimin e paragrafit 1 të tij lidhur me të cilin nuk aplikohen afatet e parashkrimit e kushtëzon, siç është sqaruar më lart, në plotësimin e dy kushteve, (i) që pronari të dëshmojë se mbi sendin, kthimin e të cilit e kërkon, ka të drejtën e pronësisë; dhe (ii) që sendi përkatës gjendet në zotërimin faktik të të paditurit. Në rrethanat e rastit, kushti i parë nuk është plotësuar, sepse parashtruesja e kërkesës, përtej pretendimeve që është trashëgimtare e pronës kontestuese, ajo dhe paditësit e tjerë asnjëherë nuk e kanë pasur këtë pronë në pronësinë e tyre.
52. Në këtë aspekt dhe bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata thekson se parashtruesja e kërkesës (i) nuk ka argumentuar se si ky interpretim i ligjit nga

- Gjykata e Apelit është qartazi i gabuar apo arbitrar dhe të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesen e kërkesës; dhe rrjedhimisht (ii) nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e saj për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
53. Gjykata më tej edhe një herë rikujton qëndrimet e saj se, në parim, interpretimi i ligjit është kompetencë e gjykatave të rregullta. Për më tepër, “*drejtësia*” që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së nuk është drejtësi “*substanciale*”, por drejtësi “*procedurale*”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para gjykatës. (Shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës nr. KI42/16, parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty; KI49/19, parashtrues *Limak Kosovo International Airport SH.A., "Adem Jashari"*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shtatorit 2019, paragrafi 55; dhe KI118/18, parashtrues “*Eco Construction sh.p.k*”, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shtatorit 2019, paragrafi 48).
54. Gjykata gjithashtu thekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta në një kontest civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb. (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI42/15, parashtrues *Habib Makiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 1 nëntorit 2016, paragrafi 43; dhe KI118/17, parashtrues *Šani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 26 shkurtit 2018, paragrafi 36).
55. Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtrueses së kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendime të argumentueshme për shkeljen e të drejtave kushtetuese. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
56. Përkundrazi, është detyrim i parashtrueses së kërkesës që t’i mbështesë pretendimet e saj kushtetuese dhe të paraqesë prova *prima facie* që tregojnë për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës nr. KI19/14 dhe KI21/14, me parashtrues, *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 dhjetorit 2013, paragrafët 26 dhe 27; dhe KI99/19, me parashtruesen, *Persa Raicevic*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 janarit 2020, paragrafi 50).
57. Parimi i njëjtë vlen edhe për pretendimet e parashtrueses së kërkesës përkitazi me referimin e saj në procedura të tejzgjatura gjyqësore. Gjykata thekson se parashtruesja e kërkesës në këtë aspekt pretendon shkelje të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së pa argumentuar dhe arsyetuar shkeljen e të njëjtave përmes Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit. (Shih, ndër të tjera në këtë aspekt, rastin e Gjykatës nr. KI68/17, me parashtrues, *Hysni Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 4 qershorit 2018, paragrafi 32; dhe KI99/19, cituar më lart, paragrafi 51).

58. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton praktikën e GJEDNJ-së, e cila lidhur me gjykimin brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar se, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit të veçantë, duke marrë parasysh kriteret e vendosura nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe në veçanti (i) ndërlikueshmërinë e rastit; (ii) sjelljen e palëve në procedurë, sjelljen e gjykatës kompetente ose autoriteteve të tjera publike; si dhe (iii) rëndësinë të cilën çështja konkrete juridike ka për parashtruesin përkatës të kërkesës. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Mikulic kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002, paragrafi 38; dhe rastin e Gjykatës KI13/19, me parashtrues *Fevzi Hajdari*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 prillit 2019, paragrafi 66). Gjykata thekson se parashtruesja e kërkesës nuk ka parashtruar asnjë argument para Gjykatës në këtë kontekst.
59. Gjykata në këtë aspekt dhe për më tepër, thekson se fakti i thjeshtë që parashtruesja e kërkesës nuk është e kënaqur me rezultatin e Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit apo vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit përkatës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse. (Shih, në këtë aspekt, rastin e Gjykatës KI136/14, me parashtrues, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33; dhe KI99/19, cituar më lart, paragrafi 52).
60. Prandaj, në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesja e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ajo, Gjykata, duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesja e kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e saj për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të saj të garantuara me nenin 31 të Kushtetutë në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

(ii) Përkitazi me pretendimet për shkelje të së drejtës në pronë

61. Gjykata rikujton që parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendon se ajo, si trashëgimtare e të ndjerit V.Z.Z., në mënyrë arbitrare është privuar nga e drejta e pronës në kundërshtim me garancitë e nenit 46 të Kushtetutës dhe nenin 17 të DUDNJ-së.
62. Në kontekst të pretendimeve të parashtrueses së kërkesës për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, përkatësisht të drejtës në pronë, Gjykata gjithashtu i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në interpretimin e nenit 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
63. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton që Kushtetuta e Kosovës, e garanton (i) të drejtën në pronë në paragrafin e saj të parë; (ii) përcakton se shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik, në paragrafin e saj të dytë; (iii) përcakton se askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona në paragrafin e saj të tretë; dhe (iv) përcakton mënyrën e eksproprijimit të pronës në paragrafin e saj të katërt dhe të pestë, respektivisht. E drejta e pronës, është po ashtu e garantuar përmes nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, dhe i cili, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, garanton të drejtën e gëzimit

- paqësor të “pasurisë”, përfshirë garancitë që askush nuk mund të privohet nga prona e tij/saj, përveç kur është në interes publik dhe i nënshtrohet (i) kushteve të parapara në ligj; dhe (ii) parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. (Shih, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 31 gushtit 2019, për nenin 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së lidhur me Mbrojtjen e Pronës; Pjesa II. Çështjet e Përgjithshme; A. Aplikueshmëria e nenit 1 të Protokollit 1 – “Pasuritë”; pika a. “kuptimi autonom”; pika b “pasuritë e mbrojtura”; dhe pika i “pritjet legjitime”).
64. Gjykata më saktësisht thekson se koncepti i “pasurisë”, i reflektuar në pjesën e parë të nenit 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së është autonom dhe përfshin të dyja (i) “pasurinë ekzistuese”; dhe (ii) asetet, përfshirë kërkesat në lidhje me të cilat parashtruesi mund të pretendojë se ka të paktën një “pritje legjitime”. Prandaj, kur pretendohen shkelje të drejtave pronësore, një parashtrues duhet të tregojë se ekziston ose një “pasuri ekzistuese” ose një “pritje legjitime” që ndërlidhet me një “pasuri” përkatëse.
65. Rrjedhimisht, në parim, neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së vlen vetëm për “pasurinë” ekzistuese të një personi. (Shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së, *Marckx kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 13 qershorit 1979, paragrafi 50; dhe *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 11 janarit 2007, paragrafi 64). Kështu, një parashtrues mund të pretendojë shkelje të nenit 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së vetëm për atë që vendimet e kontestuara ndërlidhen me “pasurinë” e tij ose të saj në kuptimin e kësaj dispozite. (Shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së *Pressos Compania Naviera dhe të tjerët kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 20 nëntorit 1995, paragrafi 31; *J.A. Pye (Oxford) Ltd dhe J.A. Pye (Oxford) Land Ltd kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 20 nëntorit 1995, paragrafi 61; *Von Maltzan dhe të tjerët kundër Germanisë*, Vendim i 2 marsit 2005, paragrafi 74; si dhe rastet e Gjykatës: KI44/16, parashtruese, *Biljana Topko*, Aktvendim për papranueshmëri i 31 marsit 2017, paragrafi 41; dhe KI26/18, parashtrues “Jugokoka”, Aktvendim për papranueshmëri i 26 shtatorit 2018, paragrafi 49).
66. Në të kundërtën, shpresa për njohjen e një të drejte pronësore, e drejtë kjo e cila nuk ka mundur të ushtrohet në mënyrë efektive, nuk mund të konsiderohet një “pasuri” brenda kuptimit të nenit 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së. (Shih në këtë aspekt, rastet e GJEDNJ-së, *Prince Hans-Adam II i Lihtenshtajnit kundër Gjermanisë*, Aktgjykimi i 12 korrikut 2001, paragrafët 82 – 83; *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke*, Vendim i 10 korrikut 2002, paragrafi 69; *Kopecký kundër Sllovakisë*, cituar më lart, paragrafi 35(c); dhe *Centro Europa 7 S.R.L. dhe di Stefano kundër Italisë*, Aktgjykim i 7 qershorit 2012, paragrafi 172).
67. Prandaj, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, një person që ankohet ose pretendon shkelje të së drejtës së tij/saj pronësore, para së gjithash duhet të tregojë që një e drejtë e tillë ka ekzistuar. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Pišturová kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim i 26 tetorit 2004, paragrafi 38; *Des Fours Walderode kundër Republikës Çeke*, Vendim i 18 majit 2004; dhe *Zhigalev kundër Rusisë*, Aktgjykim i 6 korrikut 2006, paragrafi 131).

68. Megjithatë, në rrethana të caktuara, siç u sqarua më lart, një “*pritje legjitime*” për fitimin e një asemi mund gjithashtu të gëzojë mbrojtjen e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Pressos Compania Naviera S.A. dhe të tjerët kundër Belgjikës*, cituar më lart, paragrafi 31; ndërsa për dallim, shih rastin *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke*, cituar më lart, paragrafi 73).
69. Në këtë drejtim, dhe që një “*pritje*” të jetë “*legjitime*”, ajo duhet të jetë e një natyre më konkrete sesa një shpresë e thjeshtë dhe të bazohet në një dispozitë ligjore ose një akt juridik, siç është një vendim gjyqësor, duke pasur parasysh interesin e pronës në fjalë. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Kopecký kundër Sllovakisë*, cituar më lart, paragrafët 49-50; *Centro Europa 7 S.R.L. dhe di Stefano kundër Italisë*, cituar më lart, paragrafi 173; dhe *Saghinadze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, Aktgjykim i 17 majit 2010, paragrafi 103).
70. Në të kundërtën, nuk mund të thuhet se lind ndonjë “*pritje legjitime*” atje ku ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe aplikimin e së drejtës së brendshme dhe atje ku parashtruesit përkatës, janë hedhur poshtë më pas nga gjykatat kombëtare. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Anheuser-Busch Inc kundër Portugalisë*, cituar më lart paragrafi 65; *Centro Europa 7 S.R.L. dhe di Stefano kundër Italisë*, cituar më lart, paragrafi 173; *Béláné Nagy kundër Hungarisë*, cituar më lart, paragrafi 75; *Karachalios kundër Greqisë*, Vendim i 24 janarit 2017, paragrafi 46; dhe shih gjithashtu rastet e Gjykatës KI129/16, parashtrues “*KOSBAU GmbH*”, Aktvendim për papranueshmëri i 13 nëntorit 2017, paragrafi 40; dhe KI81/19, parashtrues *Skender Podrimqaku*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 71).
71. Në rrethanat e rastit të konkret, prona kontestuese nuk mund të klasifikohet as si “*pasuri ekzistuese*” dhe as si “*pasuri*” mbi të cilën parashtruesja e kërkesës mund të ketë “*pritje legjitime*”. Kjo sepse, siç është theksuar më lart, vetëm shpresa e fitimit të së drejtës në një pronë nuk ngërthen në vetvete të drejtën për të konsideruar se prona përkatëse është një “*pasuri*” në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, prona kontestuese ishte ndarë në mes trashëgimtarëve të caktuar në vitin 1971, përmes Aktvendimit [T.nr.151/71] mbi Trashëgiminë dhe se procedurat gjyqësore nga parashtruesja e kërkesës dhe shtatë (7) paditësit e tjetër, kishin filluar vetëm në vitin 2009, me ç’rast gjykatat kishin refuzuar të njëjtën, duke arsyetuar se e drejta e paditësve përkitazi me pronën në fjalë ishte parashkruar bazuar në ligjin e aplikueshëm.
72. I njëjti parim vlen edhe përkitazi me “*pritjet legjitime*”, e të cilat bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet të jenë të një natyre konkrete, dhe të bazohen në një akt ligjor, përfshirë edhe vendim gjyqësor, dhe nuk mund të ekzistojnë atëherë kur ka një kontest përkitazi me interpretimin dhe aplikimin e një ligji dhe kur pretendimet e paditësve, siç është rasti në rrethanat e rastit konkret, janë refuzuar nga gjykatat e rregullta.
73. Gjykata rikujton se në harmoni me praktikën e GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, parashtruesja e kërkesës mund të pretendojë shkelje të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së vetëm për atë sa vendimet e kontestuar kanë të bëjnë me “*pasurinë*” e saj. Kjo pronë, siç është sqaruar më

lart, mund të interpretohet si “pasuri ekzistuese”, apo edhe “pasuri” përkitazi me të cilën ajo mund të ketë një “pritje legjitime” që do të fitojë ndonjë të drejtë pronësore. Në rrethanat e rastit konkret, parashtuesja e kërkesës nuk ka dëshmuar se pretendimet e saj ndërlidhen me ndonjërin nga kategoritë e lartcitura të të drejtave të saj pronësore të garantuara përmes nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së.

74. Prandaj në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtuesja e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ajo, Gjykata, duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që përpos pretendimeve lidhur me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së siç është sqaruar tashmë, parashtuesja e kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm as pretendimet e saj për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të saj të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së dhe nenin 17 të DUDNJ-së.
75. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të shpallet e papranueshme bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 47 e 48 të Ligjit dhe në rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenet 20, 47 e 48 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) e 59 (2) të Rregullores së punës, më 22 prill 2020, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

Gresa Caka-Nimani



Arta Rama-Hajrizi